

MIRATOHET

ING. AGRON HYSENLLIU
DREJTORI I PERGJITHSHEM

RREGULLORE E BRENDSHME

**PER PERZGJEDHJEN E BASHKEPUNETOREVE TE JASHEM PER KRYERJEN E
OPONENCAVE TEKNIKE PER PROJEKTET E NDERTIMIT TE OBJEKTEVE ME
VLERE TE PREVENTIVUAR JO ME PAK SE 100 MILJON LEKE**



INSTITUTI I NDERTIMIT

NENI 1 OBJEKTI

1. Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e procedurës së përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm, të cilët duhet të angazhohen në kryerjen e Oponencave Teknike për Projektet e Ndertimit të Objekteve me vlerë të preventivuar jo më pak se 100 milion leke
2. Kjo rregullore përcakton kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, duke siguruar kritere dhe rregulla të njëjta për bashkëpunëtorë të jashtëm në kryerjen e oponencave teknike, si dhe duke garantuar pjesëmarrjen aktive të tyre

NENI 2 BAZA LIGJORE

Kjo rregullore mbështetet në Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, Ligji nr. 7582 date 13.07.1992 me ndryshime “Për Ndermarrjet Shtetërore”, Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.1055 datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, Urdhëri i Ministrit, nr 197 date 09.10.2014 “Për miratimin e kushteve të Përgjithshme të Marreveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.....

NENI 3 SUBJEKTET

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë , **bashkëpunëtorë të jashtëm**, të cilët kërkojnë të ofrojnë shërbimet e tyre, për të ndihmuar Institutin e Ndertimit në realizimin e detyrave kryesore të saj si më poshtë:
 - në hartimin e Oponencave Teknike për Projektet e Ndertimit të Objekteve me vlerë të preventivuar jo më pak se 100 milion leke për Projektin e Konstruksionit, Projektin Arkitektonik, Projektin e Vleresimit Mjedisor, Projektin e Infrastruktura Rrugore, Projektin Elektrik, Projektin Hidroenergjitik, Projektin Hidroteknik, Projektin e instalimeve Hidrosanitare.
2. Me urdhër të Titullarit të Institutit të Ndertimit ngrihet një Komision, i përbërë nga 5 anëtarë, i cili do të realizojë përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm sipas procedurave të përcaktuara në këtë Rregullore.

NENI 4

REGJISTRIMI I KANDIDATËVE - BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

1. Mbështetur në këtë rregullore, të drejtën për tu perzgjedhur si bashkëpunëtorë të jashtëm për kryerjen e oponentave teknike për Projektet e ndertimit të Objekteve me vlerë të preventivuar jo më pak se 100 milion leke e gëzojnë të gjithë personat që plotësojnë këto kritere:

1.1 Kërkesa të përgjithshme:

- a) përvoja në fushën inxhinierike
- b) licenca
- c) Të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- d) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- e) Të kenë aftësi për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj;
- f) Të përdorin kompjuterin, në programet SAP dhe ETABS

1.2 Kërkesa të veçanta për bashkëpunëtorët e jashtëm

- a) Të kenë mbaruar arsimin e lartë në Deget: Ndertim, Konstruksion, Arkitekture, Hidroteknik, Elektrik, Mekanike, Infrastruktura Rrugore, Mjedis.
- b) Të kenë përvojë aktive në profilet respektive mbi 15 vjet
- c) Të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillim të tyre profesional.

2. Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për Aplikim;
- b) CV;
- c) Fotokopje e diplomës së shkollës së lartë, e noterizuar;
- d) License të noterizuar

(Për Konstruktoret kerkohet: Kategoria "Projektim për objekte mbi 8 kate", ose "Projektim objekte me vështirësi të shkallës së lartë").

(Për Infrastrukturen Rrugore kerkohet: Projektim Rruge Kategoria I-re)

NENI 5

PËRZGJEDHJA E KANDIDATËVE

1. Njoftimi për shpalljen e interesit për bashkëpunëtorë të jashtëm publikohet në faqen zyrtare të Institutit të Ndertimit .

2. Njoftimi për shpalljen e interesit për bashkëpunëtorë të jashtëm duhet të përmbajë:

- a) listën e dokumenteve që duhen paraqitur;
- b) kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët

c) afatin e fundit dhe adresën ku duhet të paraqiten dokumentet.

3. Për kryerjen e procedurave të seleksionimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve do të merret Komisioni i cili vlerëson kandidatet mbi bazën e dosjeve të tyre .

4. Në përfundim të vlerësimit të kandidateve, komisioni merr vendim dhe harton listen e bashkepunetoreve që i plotesojnë kriteret e vendosura.

NENI 6 KOMISIONI

1. Komisioni i ngritur për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm përbëhet si më poshtë:

- a) Kryetari i Komisionit (Titullar i Institucionit);
- b) Drejtor i Drejtorise së Rregullave Teknike dhe Oponencave ;
- c) Përgjegjësi i Sektorit
- d) Specialisti Ing. Ndertimi, Infrastruktura.
- e) Juristi

2. Anëtarët e Komisionit, përpara se të bëjnë përzgjedhjen e kandidatëve, duhet të nënshkruajnë një deklaratë, që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me personat pjesëmarrës si bashkëpunëtorë të jashtëm.

NENI 7 VLERËSIMI I KANDIDATËVE

1. Komisioni shqyrton dokumentacionin e kandidatëve dhe në përfundim të vlerësimit, merr vendim dhe harton listen e bashkepunetoreve që i plotesojnë kriteret e vendosura.

me vendim përcakton listen e bashkepunetoreve të jashtëm në përputhje me kriteret përkatëse.

2. Komisioni mban procesverbal lidhur me vlerësimin e të përzgjedhurve si dhe shpall listen e të gjithë konkurrenteve së bashku me vlerësimet % për secilin kandidat sipas fushes.

3. Komisioni i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

4. Lista kalon për miratim në Këshillin Drejtues të Institutit të Ndertimit

5. Pas miratimit të listës në Këshill Drejtues, kjo listë dërgohet për aprovim në MZHUT.

NENI 8 PUBLIKIMI

Të gjitha njoftimet lidhur me procedurat e aplikimit do të gjenden në adresën e internetit të Institutit të Ndertimit

Ne faqen e internetit do të shpallet dhe lista e miratuar e bashkepunetoreve të jashtëm.

NENI 9 PËRZGJEDHJA E BASHKEPUNETOREVE PER KRYERJEN E Oponenceve TEKNIKE NE DEPARTAMENTIN E RREGULLAVE TEKNIKE DHE Oponenceve

1. Me urdhër të Titullarit të Institutit të Ndertimit ngrihet një grup pune, i përbërë prej 3 anëtarësh, i cili do të realizojë përzgjedhjen e bashkëpunësorëve të jashtëm për çdo Projekt të ardhur për kryerje Oponence Teknike.

2. Grupi i punës kryesohet nga Drejtori i Departamentit, një specialist, i cili ndryshon sipas specialitetit të Projektit që kërkohej të kryhet Oponenca Teknike, dhe Juristja e IN-se.

3. Pas përzgjedhjes, të drejtën e marrjes së vendimit e ka Drejtori i Përgjithshëm, i cili nënshkruan Kontratën-Marrëveshje me bashkëpunëtorin e jashtëm.

NENI 10 TË DREJTAT DHE DETYRAT E BASHKËPUNËTORË TË JASHTËM

1. Bashkëpunësorët e jashtëm të përzgjedhur sipas nenit 9, në momentin që kontaktohen nga Drejtori i Drejtorisë së Rregullave Teknike dhe Oponenceve për kryerjen e një oponence, do të paraqitet pranë kësaj Drejtorie për marrjen e dokumentacionit teknik ligjor.

2. Trajtimi financiar i bashkëpunësorëve, do të kryhet sipas % së përcaktuar në Vendimin e Këshillit Drejtues.

NENI 11 PËRZGJEDHJA E KANDIDATËVE NE KOHE EMERGJENCE

Në kohë emergjencash, KD ka të drejtën e përzgjedhjes së Bashkëpunësorëve të jashtëm kur ato nuk janë në listën e miratuar.

NENI 12 ZBATIMI I RREGULLORES

Personeli i Institutit te Ndertimit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm janë të detyruar të respektojnë kërkesat e kësaj rregulloreje.

NENI 13
NDRYSHIMI APO SHFUQIZIMI

1. Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në këtë rregullore bëhen me propozim të te Keshillit Drejtues dhe te Drejtorise se Rregullave Teknike dhe Oponencave dhe miratimit i tyre behet nga KD.

2. Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në këtë rregullore hyjnë në fuqi pas miratimit nga KD i Institutit te Ndertimit.

NENI 14
HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Keshilli Drejtues i Institutit te Ndertimit

NENI 15
DISPOZITA E FUNDIT

Pas miratimit të kësaj rregulloreje nga ana e Keshillit Drejtues te Institutit te Ndertimit, çdo akt administrativ që rregullon çështjet e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet.

NENTOR 2014

